

AFATET E PAGESAVE

1: TAKSAT VENDORE

1.1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL

Afati dhe mënyra e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

1.2.TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

1.2.1. Taksa mbi ndërtesat

1.Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo, për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

1.2.2. TAKSA E TOKËS BUJQËSORE

Taksa mbi tokën bujqësore është një detyrim vjetor.

1.2.3. TAKSA E TRUALLIT

Afatet kohore të pagesës: Taksa do të paguhet gjatë vitit kalendarik.

1.3.TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo komunës, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

1.4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Afati kohorë i pagesës së takse është 28 ditë nga vlerësimi teknik pozitiv.

1.5. TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

1.6. TAKSA E ZËNIES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Pagesa kryhet para lidhjes së marrëveshjes midis palëve.

1.7. TAKSA E TABELËS.

Taksa e tabelës është një detyrim vjetor.

Afati i pagesës: është 20 prill dhe për subjektet e reja në momentin e rregjistrimit të subjektit.

1.8. TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet.

2: TARIFAT VENDORE

2.1. TAKSA E PËRKOHËSHME NË INFRASTRUKTURËN ARSIMORE.

Detyrimi për taksën e përkohshme në infrastrukturën arsimore është vjetore. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati përfundimtar i pagesës është data 30 Mars 2021. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor është 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

2.2. TARIFA E PASTRIMIT DHE E LARGIMIT TË MBETURINAVE

“Familjarët”: Detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së shërbimeve publike do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

“Biznesi”: Detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

“Subjekte Ndërtimi” nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to “Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi

e tregtare, etj. të ngjashëm me to”, llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Klos të kërkesës për leje shfrytëzimi.

2.3. TARIFA E NDRIÇIMIT DHE GJELBËRIMIT

Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së ndriçimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të sajë në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Institucionet dhe biznesit: Detyrimi paguhet brenda datës 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

2.4. TARIFË VENDORE PËR SHFRYTËZIMIN E LËNDËS DRUSORE

Tarifa e furnizimit me dru zjarri është detyrim vjetore.

2.5. TARIFA VENDORE PËR VEPRIMTARITË E KËRKIMIT, ZBULIMIT, DHE SHFRYTËZIMIT TË MINERALEVE TE DOBISHME (KROM). Tarifa vendore për veprimtaritë e kërkimit, zbulimit, dhe shfrytëzimit të mineraleve të dobishme është detyrim vjetor që përfshin veprimtarinë e të gjithë subjektëve që operojnë brenda territorit të Bashkisë Klos.

2.6. TARIFË VENDORE PËR VEPRIMTARINË E IMPJANTËVE, FABRIKAVE TË PASURIMIT TE MINERALËVE. Tarifa vendore për veprimtarinë e impjantëve, fabrikave të pasurimit të mineralëve dhe ndërtimit të hidrocentralëve, termocentraleve...etj, është detyrim vjetor që përfshin veprimtarinë e gjithë impjantëve që operojnë brenda territorit të Bashkisë Klos.

2.7. TARIFË VENDORE PËR VEPRIMTARINË E HIDROCENTRALËVE, TERMOCENTRALËVE (Hidrocentralet me kapacitet nga 5 deri në 10 mega vat). Tarifë vendore për veprimtarinë e hidrocentralëve, termocentralëve Hidrocentralet me kapacitet nga 5 deri në 10 mega vat është detyrim vjetor.

2.8. TARIFË VENDORE PËR VEPRIMTARINË E HIDROCENTRALËVE, TERMOCENTRALËVE (Hidrocentralet me kapacitet nga 5 deri ne 10 mega vat). Tarifë vendore për veprimtarinë e hidrocentralëve, termocentralëve Hidrocentralet me kapacitet nga 5 deri ne 10 mega vat është detyrim vjetor.

2.9. TARIFË VENDORE PËR VEPRIMTARINË E HIDROCENTRALËVE, TERMOCENTRALËVE (Hidrocentralet me kapacitet mbi 10 mega vat). Tarifë vendore për veprimtarinë e hidrocentralëve, termocentralëve Hidrocentralet me kapacitet mbi 10 mega vat është detyrim vjetor.

2.10. TARIFË VENDORE PËR SHFRYTËZIMIN E PESHKUT (GJUE TISË DHE E PESHKIMIT AMATOR).

Tarifa vendore për veprimtarinë e shfrytëzimit të peshkut është detyrim vjetor që përfshin veprimtarinë e subjekteve të shfrytëzimit të peshkut që operojnë brenda territorit të Bashkisë Klos.

2.11. TARIFË VENDORE PËR KOMPLEKSET BLEGTORALE

Tarifa vendore për komplekset blegtorale, është detyrim vjetor që përfshin veprimtarinë e gjithë komplekseve blegtorale të gjedhëve dhe të imtave, që operojnë brenda territorit të Bashkisë Klos.

2.12. TARIFË SHËRBIMI

2.12.1. PËR UJIN E PIJSHËM.

Kjo tarifë është mujore.

2.12.2. PËR UJIN VADITËS

Kjo tarifë është sezonale, që planifikohet dhe mblidhet vetëm për periudhën e vaditjes.

2.13. DHËNIA E PASURIVE ME QERA

Kjo tarifë është mujore.

2.14. TARIFË PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE

Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Afati kohor i pagesës se dhenive të lejeve dhe autorizimeve është në varësi të lidhjes së kontratës, mujore ose vjetore.

2.15. TARIFË VENDORE PËR FREKUENTIMIN E FËMIJËVE NË KOPËSHTIN PUBLIK.

Tarifa vendore për frekuentimin e fëmijëve në kopshtin publik me drekë është detyrim mujor.